



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ / /

Datë: 09.03.2020

Procesverbal

i mbledhjes se II (e dytë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- të jashtëzakonshme të KPF-së, për vitin 2020.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2019.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/1 datë:28.01.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të Dtaft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/24 datë:14.02.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të propozim Rregullores së Tatimit në Pronë për vitin 2020.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/113 datë:10.02.2020, për miratimin e Projektpropozimit të Planit vjetor të punës së KKS-së për vitin 2020.
6. Raporti i DKA-së, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2019/20.
7. Plani i Punës i Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë.
9. Raporti i Punës së Qendrës për Punë Sociale për vitin 2019
10. Plani i Punës së Qendrës për Punë Sociale për vitin 2020
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve të punës i Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2019.
 - Komitetit për Komunitete
 - Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
 - Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
 - Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës
 - Komitetit për Diasporë
 - Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike
 - Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
 - Komisionit Komunal të Aksionarëve
12. Shqyrtimi i kërkesave .
13. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 20.02.2020 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e dytë disa materiale si kemi në mbledhje unë që në fillim të vitit ju kam dërguar me shkrim për pikat që janë në plan të punës, tani edhe Strategjinë e veprimit dhe komunikimit na kanë sjellë zyra për informim.

Valon Krasniqi: Kërkoj që edhe draft rregullorja për subvencione dhe transfere të futet në rend të ditës.

Alban Krasniqi: Po e ngris një çështje rreth vizitës tuaj në Itali, ai proces nuk ka qenë transparent me mungesë të informacionit, tejkalim i autorizimeve dhe ska pas kurrfarë bashkëpunimi lidhur me atë vizitë. KPF nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me atë vizitë. Unë kërkoj dokumente si ftesën e asaj vizite dhe dokumentet tjera që tju drejtohem Agjencionit Kundër Korrupsionit dhe MAPL që të dijmë se a lejohet si anëtar i Kuvendit me shku në vizitë, a ka pas konflikt interesi, vet veprimtaria e asaj kompanie ka rënë në kundërshtim me disa vendime që janë marrë në kuvend. Janë përdorur fonde publike për një vizitë private dhe kërkoj që ato fonde të kthehen, sepse s'mundesh mi përdore jashtë veprimtarisë tonë, dhe ka rënë në kundërshtim me Ligjin dhe do të kërkoj që të ndërmerren masa nga Agjencioni. Ditën kur a caktu mbledhja një ditë përpara kam ardhë prej Tiranës dhe mbasi kam ardhë me keni njoftuat dhe për shtyrje është dashtë të informohen shefat e grupeve pasi që përbërja në atë vizitë dhe agjenda kanë qerë të kundërligjshme sikurse edhe pagesa dhe po ashtu karakteri i vizitës tuaj ka qenë në kundërshtim me interesin qytetarë. Nëse ajo kompani kërkon diçka nga Kuvendi ne do të kërkojmë të hetohet procesi, sepse ju jeni rënë pre e mashtrimit dhe karvan i asaj vizite ka qenë ka qenë një kompani biznesore sepse veprimtari të ngjashme i kemi pas pezulluar. Rrahim Morina: Ju nëse dëshironi këtë komunikim e fusim si pikë në rend të ditës në Kuvend, veç një po ju them kjo vizitë ska pas skenar, ne na ka njoftuar kryetari bile prej t'i kam kërkuar që ai vet meju njoftuar se njëherë ka thënë krejt KPF me shku tani jo veç nga një anëtar. Albani ka thënë se ftesa si ka plotësuar kriteret ne ato ftesa me Hashimin i kemi dërguar në Ambasadë, kur kemi shku aty në Ambasadë na kanë thënë se Blerta si ka plotësuar të gjitha dokumentet e tani është dashtë të nesërmen mi dorëzuar unë jam me bashkëpunuar por ajo vizitë nuk ka qenë private.

Alban Krasniqi: Unë kërkoj nga Muharremi krejt materialet te mi jep rreth vizitës në Itali, vendimin e kryetarit, biletat.

Valon Krasniqi: Sa i përket vizitës nga fillimi na është thënë të gjithë anëtarëve tani kryetari ka thënë jo veç katër vetë e në fund janë shkuar pesë. Ldk në atë vizitë nuk është përfaqësuar dhe kryetari e ka përçarë bashkëpunimin opozitarë.

Raimonda Krasniqi: Kryetari na ka njoftuar unë kam dashtë që kjo punë të shkojë në formë ligjore dhe jo që s'kam dashtë me shkuar por jo me shkue në vizitë me para të Komunës.

Hashim Vrenezi: Nuk po me vjen mirë Alban që po përsëritësh, organizimi i asaj vizite ka qenë nga kryetari i Komunës Ragip Begaj se prej tij i kemi marrë ftesat, prezantimi gojor ka qenë në kpf dhe a është shkelje a jo t'i sje kompetent mu marrë me këtë çështje dhe këtu ne s'kemi bashkëpunim të shkruar, vetën ne të mirë të qytetarëve.

Alban Krasniqi: Ky proces ka qenë proces në hije e jo qysh mi ftu investitorët dhe s'jeni shku për interes të qytetarëve.

Rrahim Morina: A keni diçka për rendin e ditës?

Hashim Vrenezi: Ne pse me ngarkuar asamblenë me pika të rendit të ditës pa materiale

Alban Krasniqi: Materialet le ti kemi të skanuara në adresa kush ka email.

Rrahim Miorina: Kush jeni që ato pika që ka material të futen, ato që nuk kanë të hiqen nga rendi ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- të jashtëzakonshme të KPF-së, për vitin 2020.

Unanimisht ishin për miratim të procesverbalit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Alban Krasniqi: Përse mbi 1 milion euro nuk janë shpenzuar, të Bujqësia janë dy zëra dhe mjetet fare s'janë shpenzuar si në farë, pleh dhe makina e këto janë bërë qëllimshëm. Të na silltet shuma e cila ka kaluar në suficit dhe tani kemi të drejt mi ridestinuuar, sepse janë planifikuar e s'janë realizuar pra si Kuvend i ridestinojmë në projekte tjera.

Të kemi raport nga Kryetari i Komunës sa mjete kanë kaluar në suficit, cilat projekte kanë dështuar, arsytet e dështimit për secilin projekt.

Hashim Vrenezi: Ky raport i ngjashëm me raporte tjera ka gabime teknike dhe ka suficit të madh dhe ka projekte që s'janë realizuar. Të kemi specifikacion të projekteve që janë realizuar me pranim teknik për secilin projekt me pagesa në total për secilin projekt sipas kontratës dhe punë shtesë nëse ka pas. Janë shpenzime të mëdha në vendime gjyqësore për secilin rast të dimë, dhe të kemi specifikacion për listën e shërbimeve kontraktuese tjera.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/11 datë:28.01.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të Dtaft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.

Rrahim Morina: Drejtori me ka thënë se nuk ka asnjë ndryshim në rregullore.

Alban Krasniqi: Është dashtë me pas një shkresë nëse ska asnjë ndryshim, edhe unë jam kundër taksave por ne të kemi informacion sa janë të hyrat që janë inkasuar nga rregullorja gjatë vitit 2019.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/24 datë:14.02.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të propozim Rregullores së Tatimit në Pronë për vitin 2020.

Alban Krasniqi: Një raport ta kemi mbi dëgjimin publik të kësaj draft rregullore, sa dëgjime publike janë mbajtur, çka është integruar dhe a ka pas ndonjë ndryshim.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/13 datë:10.02.2020, për miratimin e Projektpropozimit të Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2020.

Halit Mazreku: Malisheva është ndër Komunitet me të qeta, me 2019 ska pas asnjë konflikt ndër fetar apo etnik, KKSB në Maj ka vizituar komunitetin Rom dhe ata e ndiejnë veten të sigurte dhe të qete. Ky plan do të jetë si koordinim i punëve për objektivat e sigurisë.

Alban Krasniqi: Ishte dashtë me kanë lista e anëtarëve dhe KKSB, plani nuk është dashtë të jetë pa raport të punës, pse na veç 10 përlind me debatë veç për minoritete ose bashkësi fetare ose mu mbajt takim, kjo shkon përtej kësaj. Kuvendi kurrë ska marrë asnjë informacion prej KKSB-së.

Pastaj me pas informacion rreth dhunës dhe ngacmimeve seksuale si informacione mirë është mi pas.

Hashim Vrenezi: Këtu ne plan thuhet janë paraparë broshura por mirë është me ditë a ka pas.

Rrahim Morina: Mbetet në Mars të hyn informimi i KKSB, pra nuk po e dërgojmë në Kuvend.

6. Plan i Punës i Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020.

Alban Krasniqi: A ka raportuar në baza ligjore, pse mos me pas një raport nga Auditori ne mund ta rekomandojmë por jo pa raport me shkrim në kuvend.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend plus të kërkojmë raport me shkrim nga Auditori i brendshëm? Unanimisht ishin për kjo pike të rekomandohet për kuvend.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë.

Izet Shala: Tani Strategjia dhe Plan i veprimit janë për periudhën 4 vjeçare, është bërë një lëvizje në informim publik qasja në dokumente është në nivel të mirë dhe kemi treguar efikasitet si Komunitet.

Valon Krasniqi: Ka pas raste kur ueb faqja ska pas informacione të drejta si projekti për fshatin bardh se thotë ka fillu projekti pa fillu fare.

Alban Krasniqi: Lidhur me kualitetin e informimit merrne barrën edhe pak kohe deri sa të çliroheni, ky Plan është i mangët. Të futet çdo vit edhe plani i veprimit sepse secili aktivitet ka indikator, kosto. Plotësoni ueb faqen me rregullore dhe krejt informacionet të futen aty.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

9. Shqyrtimi dhe miratimi draft rregullores për Subvencione dhe Transfere.

Alban Krasniqi: Nëse janë integruar propozimet mundemi me votë nëse jo letë shtyhet për muajin Mars.

10. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/48 datë: 11.02.2020 të parashtruar nga Sefedin Kozhani nga Ribari i Madh, Komuna e Lipjanit.

Rrahim Morina: Ketë kërkesa ja përcjellim kryetarit të Komunës.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/45 datë: 31.01.2020, të parashtruar nga z. Rexhep Limaj, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në toke ndërtimore.

Rrahim Morina: Kush jeni që ti drejtohem i shkresë përcjellëse Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik dhe Drejtoria për Urbanizëm që ta shqyrtojnë këtë kërkesë pasi që kërkesa në fjalë nuk është e pajisur me dokumentacionin shtesë të Drejtorive të lartcekura.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/35 datë: 28.01.2020 e parashtruar nga z. Avdyli Bytyçi nga fshati Shkozë, për mbështetje financiare për renovim të shtëpisë-dhomës së banimit.

Alban Krasniqi: Ketë si rast që i ka ndodhur nëse i trajtojmë këto raste edhe ne duhet me pas një kanar, se nëse ne pi ndihmojmë apo shkojnë mjetet për atë pse ne po i ndihmojmë.

Rrahim Morina: Kush jeni ti ndahen (500€ pesëqind euro) për mbështetje financiare?

Unanimisht ishin për miratim të kësaj kërkesë.

Kërkesa nr.02/66 datë: 18.02.2020 e parashtruar nga përfaqësuesi i Lagjes Avdullahovit të fshatit Carrallukë z. Bajram Hoti.

Rrahim Morina: Ketë kërkesa ja përcjellim kryetarit të Komunës.

Kërkesa nr.02/46 datë: 05.02.2020 e parashtruar nga zj. Mirishahe Hoxha nga fshati Temeqinë, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni ti ndahen (700€ shtatëqind euro) për mbështetje financiare?

Unanimisht ishin për miratim të kësaj kërkesë.

Kërkesa nr.02/67 datë: 18.02.2020 e parashtruar nga z. Hasan Vrenezi nga fshati Marali, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni ti ndahen (500€ pesëqind euro) për mbështetje financiare?

Unanimisht ishin për miratim të kësaj kërkesë.

Kërkesa nr.02/68 datë: 18.02.2020 e parashtruar nga z. Muhamet Krasniqi nga fshati Astrazup, për mbështetje financiare për shërim.

Alban Krasniqi: Kemi shumë familje në asistencë sociale e tash nëse dikujt i ndahen dy herë mjete e dikujt hiq nuk është në rregull.

Rrahim Morina: Nuk është mirë me shëndet se parashtruesin e kësaj kërkesë e njoh.

Hashim Vrenezi: As unë s'jam që dikujt di ndihmohet dy herë.

Rrahim Morina: Kush jeni ti ndahen (500€ pesëqind euro) për mbështetje financiare?

Unanimisht ishin për miratim të kësaj kërkesë.

Rrahim Miorina: Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14.35 minuta.

Procesmbajtësi
Naim Avdijaj jur. i dip

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina